



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 26.11.2025

Numër protokolli: 7603/2025

A.nr.1748/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1748/2025, të datës 30.09.2025 të parashtruar nga ankuesi E.Sh, nga Mitrovica, kundër organit të punësimit Ministria e Mbrojtjes, në çështjen juridike “*Transfer*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar ankesa A.nr.1748/2025, e datës 30.09.2025, e parashtruar nga ankuesi E.Sh.
- II. Anulohet** Vendimi Ref.DBN-MM-5/9652025 i datës 11.11.2025, i UD/Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Anulohet Raporti Plotësues Nr.1082 i Komisionit të Ristrukturimit për Shërbimin Civil të Forcës së Sigurisë së Kosovës të datës 13.08.2025, ndërsa lënda kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje* te organi i njëjtë.
- III. Obligohet** Komisioni i Ristrukturimit për Shërbimin Civil të Forcës së Sigurisë së Kosovës i Ministrisë së Mbrojtjes, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në pikën **II** të dispozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij.
- IV. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në pikën **III** të dispozitivit.
- V.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

Ar sy e t i m

Nëpunësi Civil, E.Sh (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 30.09.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është protokolluar me numër: 6459/2023, kundër mosveprimit të organit të punësimit lidhur me rishqyrtimin e rastit të tij sipas Vendimit të Këshillit A.nr.928/2025 të datës 23.07.2025, ndërsa me datë 21.11.2025 ankuesi e ka plotësuar ankesën e tij të datës 30.09.2025, ashtu që e kundërshton Vendimin Nr.5794 të datës 11.11.2025 të UD. Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.10.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Mbrojtjes, ndërsa kjo e fundit më datë 15.10.2025 ka dërguar përgjigje në ankesë, ndërsa me datë 11.11.2025 ka dërguar sërish prova shtesë.

Kryetari i Këshillit, me datë 06.11.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:7193/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.1748/2025 të datës 30.09.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) ndërlidhur me pretendimet ankimore administroi këto prova: Ankesën me nr. protokolli 6459/2025 të datës 30.09.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Lista e pozitive të specialistëve në Ministri të Mbrojtjes; Listën e pagës së muajit prill/2025; Vendimin e Këshillit A.nr.928/2025 të datës 23.07.2025; Raportin plotësues të datës 12.08.2025; Kërkesën e datës 05.05.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së; Kërkesën e datës 23.04.2025 e Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin e Qeverisë së Kosovës të datës 12.10.2023; Shkresë e datës 13.12.2023 me shifër: 3948/03; Kërkesën e datës 12.12.2023; Formularin për regjistrimin e ankesës të datës 30.09.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 10.10.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 15.10.2025; Akt Emërimit e ankuesit të datës 05.06.2025; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “Specialist i Administrimit të Rrjetave”; Kërkesën e datës 05.05.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MB dërguar Komisionit Shtetëror për Shqyrtimin e Pozitive të Ekspertëve; Kërkesën e datës 23.04.2025 dërguar nga Shefi i Stafit të SHPFSK-së për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 18.09.2025 dërguar nga I.M për ankuesin; Vendimin e datës 06.11.2025 të Kryetarit të Këshillit; E-mailin e datës 23.10.2025 dërguar nga Kolegji i Këshillit për MB; Përgjigje e datës 11.11.2025; Vendimin e datës 11.11.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MB-së; Kërkesë e datës 21.11.2025 për plotësimin e ankesës; Ankesën me nr. protokolli 3375/2025 të datës 21.05.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Ref.DBN-MM-5/441/2025 të datës 23.04.2025, të u.d Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes; Akt Emërimit AE.Nr.5/583/2022 të datës 24.10.2022; Akt Emërimit e datës 06.08.2013; Autorizimin e datës 14.05.20215; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.05.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 30.05.2025; Përshkrimi i vendit të punës Teknik i TI-së; Përshkrimin e punës për Specialist i Administrimit të Rrjetave-SHP0818 pa nënshkrim; Vendimin Ref.BNJ/MM 05/782025 të datës 06.02.2025 për emërimin e Komisionit të Ristrukturimit për personelit civil të FSK-së; Dëshmitë për pozita e anëtareve të Komisionit të

Ristrukturimit; Listën e pagave prill dhe maj 2025; Raportin e Komisionit të Ristrukturimit të Personelit civil të FSK-së të datës 03.04.2025; Vendimin me numër protokolli 4420 të datës 27.06.2025 për shtyrjen e afatit për vendosjes së ankesës së ankuesit;

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, ndërsa lënda duhet të kthehet në **ri-shqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë, sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankuesi sipas Akt Emërimit AE.Nr.5/585/2022 të datës 24.10.2022, është i punësuar dhe mbanë pozitën “*Specialist i Mbështetjes Teknike për Rrjeta*” në Njësinë e Komunikimit në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Fillimisht, më datë 06.02.2025 u.d. Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Mbrojtjes, përmes Vendimit Ref.BNJ/MM 05/78/2025 ka emëruar Komisionin e Ristrukturimit për personelin civil në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Tutje Komisioni i Ristrukturimit për nëpunësit civil të Forcës së Sigurisë së Kosovës, më datë 03.04.2025 ka përgatitur raportin me numër protokolli 700, përmes të cilit tek personeli i Shtabit të Përgjithshëm të Forcës së Sigurisë së Kosovës, tek pika 43 për rastin e ankuesit, ka propozuar sistemimin e ankuesit nga detyra Specialist i Mbështetjes Teknike për Rrjeta, Grada A0, NJKSI, Shtabi i Përgjithshëm, propozohet të sistemohet në detyrë Specialist i Administrimit të Rrjetave, Grada A, NJKS, Shtabi i Përgjithshëm, me numër të shërbimit SHP0818, me arsyetimin se *nëpunësi E.Sh, i punësuar në Forcën e Sigurisë së Kosovës, që nga data 06.08.2013, me kualifikim Bachelor, drejtimi Specializim në Inxhinieri Softverike, me rezultatet e vlerësimit vjetor 4.3 për vitin 2023, dhe 4.07 për vitin 2024, propozohet të risistemohet në detyrë Specialist i Administrimit të Rrjetave, Grada A, NJSK, Shtabi i Përgjithshëm me numër të shërbimit SHP0818 dhe si rrjedhojë propozimi për ri sistemimin e nëpunësit në këtë pozitë përputhet me përgatitjet e tij shkollore, përvojën e punës, kriteret e përshkrimit të detyrave të punës, duke shtuar tutje se pozita në fjalë nuk është pjesë e Katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil, por komisioni ka propozuar që klasa për këtë pozitë të përcaktohet profesional 2.*

U.D/ Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, më datë 23.04.2025 ka nxjerr Vendimin Ref.DBN-MM-5/441/2025, me të cilin pas riorganizimit të TOP-it në Forcën e Sigurisë së Kosovës, ankuesin e ka transferuar në pozitën Specialist i Administrimit të Rrjetave, SHPFSK/NJSK, Grada A, më numër të shërbimit SHP0818, ndërsa ankuesi kishte parashtruar ankesë me datë 21.05.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Ref.DBN-MM-5/441/2025 të datës 23.04.2025, të U.D/Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes, me pretendimin ankimor se akti i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me Ligjim Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me Aktgjykimin me Nr. KO79/2023 të Gjykatës Kushtetuese të Republikë së Kosovës sepse është zbritur vlera e pagës kur me këtë aktgjykim është shpall i pavlefshëm paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, si dhe në kundërshtim me ligjin material.

Këshilli pas shqyrtimit të ankesës së ankuesit të datës 21.05.2025, kishte konstatuar shkelje procedurale në këtë çështje administrative e të cilat janë pasqyruar në tersi në vendimin e Këshillit A.nr.928/2025, të cilat ishin shkaktuar nga komisioni përkatës i ristrukturimit, e për rrjedhojë duke marr parasysh shkeljet

përkatëse Kolegji i Këshillit në shqyrtim të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesë respektivisht Vendimit Ref.DBN-MM-5/441/2025 të datës 23.04.2025, të U.D/Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes, kishte konstatuar se i njëjtë akt ishte i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që sipas pikëpamjeve të dhëna si në dispozitivin e Vendimit A.nr.928/2025 të datës 23.07.2025, e kishte aprovuar ankesën e ankuesit ndërsa me qëllim të kthimit të ligjshmërisë në vend, lëndën e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje te Komisioni i Ristrukturimit për personelin civil të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ndërsa komisioni përkatës i ristrukturimit ishte sugjeruar që me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit të marr parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Tutje, Komisioni i Ristrukturimit, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Këshillit A.nr.928/2025 të datës 23.07.2025, kishte nxjerrë Raportin plotësues Nr.1082 të datës 13.08.2025 me të cilin akt i ishin drejtuar U.D/ Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, me sqarimet përkatëse se ankuesi propozohet sërish për sistemim në pozitën “Specialist i Administrimit të Rrjetave”, duke pasur parasysh përgatitjet e tij shkollore, përvojën e punës, kriteret e përshkrimit të detyrave të punës, dhe ndër tjerash Komisioni i Ristrukturimit shton faktin se duke pasur parasysh që pozita përkatëse “Specialist i Administrimit të Rrjetave” nuk është pjesë e Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ka propozuar që Klasa për këtë pozitë të përcaktohet Profesional 2, ndërsa lidhur me pozitën paraprake që ka mbajtur ankuesi “*Specialist i Mbështetjes Teknike për Rrjeta*” Komisioni i Ristrukturimit në Raportin Plotësues të datës 13.08.2025, kishte deklaruar se kjo pozitë ka pësuar ndryshime në titull, gradë dhe numër të shërbimit.

Mirëpo, pavarësisht që Komisioni i Ristrukturimit me datë 13.08.2025 kishte nxjerrë Raportin Plotësues, me të cilin i ishte drejtuar U.D/ Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, kjo e fundit nuk kishte vepruar sikurse obligohet me dispozitat e aplikuara nga 66 paragrafi 4 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “*Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit.*”, kurse ankuesi për shkak të paqartësive ligjore lidhur me Raportin Plotësues të datës 13.08.2025 dhe në mungesë të aktit me përmbajtje të këshillës juridike për të kontestuar procedurën përkatëse, me datë 30.09.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimin ankimor se organi i punësimit nuk ka vepruar sipas pikëpamjeve të dhëna juridike me Vendimin e Këshillit A.nr.928/2025 të datës 23.07.2025, kur e kishte kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Madje ankuesi pretendon se pozita të cilën e ka mbajtur sipas Akt të Emërimit AE.Nr.5/585/2022 të datës 24.10.2022, “*Specialist i Mbështetjes Teknike për Rrjeta*” nuk është shuar dhe as nuk ka ndryshuar titull, dhe as grade, por se në këtë pozitë është sistemuar një ushtarak, duke ia cenuar ankuesit një të drejtë të fituar me ligj dhe duke e dëmtuar në pagë, kurse arsyeimi Komisionit të Ristrukturimit se pozita e tij në të cilën është propozuar për transferim “Specialist i Administrimit të Rrjetave” është propozuar sipas kërkesës te Komisioni Shtetëror për Vlerësimin e Sistemeve Strategjike” me qëllim të përfshirjes në kuadër të listës së Ekspertëve, nuk paraqet siguri juridike pasi që ka ndodhur edhe ne të kaluarën se jo çdo kërkesë e organeve të punësimit aprovohet nga komisioni në fjalë.

Lidhur me parashtrimin e ankesës së ankuesit të datës 30.09.2025, Këshilli e kishte njoftuar sipas praktikës organin e punësimit përmes kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 10.10.2025, kurse pas pranimit të provave të lëndës sipas shkresës së datës 15.10.2025, zyrtari i autorizuar nga Kolegji i Këshillit me datë 23.10.2025 i ishte drejtuar me kërkesë Ministrisë së Mbrojtjes, gjegjësisht i ishte drejtuar Drejtorit të Departamentit për Politika të Personelit dhe Rekrutim D-BNJ, me njoftimin dhe kërkesën si në vijim: *I nderuari z. Mecinaj, Këshilli me datë 15.10.2025 ka pranuar shkresat e lëndës, lidhur me ankesën e ankuesit E.Sh A.nr.1748/2025 të datës 21.09.2025, mirëpo e kemi të nevojshme të marrim sqarime dhe prova eventuale shitesë, si në vijim: “A mund të na e konfirmoni faktin, nëse Drejtoria e Burimeve Njerëzore në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes, ka nxjerrë Vendim për transferimin e ankuesit, sipas Raportit Plotësues Nr.1082 të datës 13.08.2025 të Komisionit të Ristrukturimit, sikurse përcaktohet me kuadrin ligjor në fuqi; Nëse drejtoria përkatëse ka nxjerrë vendimin në fjalë, ju lutem na e përcjellni në cilësi të provës materiale; Nëse vendimi për transfer nuk është nxjerrë, ju lutem na shpjegoni arsyet e mosveprimit sipas Raportit Plotësues Nr.1082 të Ristrukturimit të datës 13.08.2025”, ndërsa ky i fundit përmes telefonatës të realizuar në lidhjen zyrtare, e kishte njoftuar zyrtarin e Këshillit, se U.D/ Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore heziton të nxjerrë akt të ri të sistemit të ankuesit, me arsyetimin se i njëjti deklarohet se ankuesi është propozuar nga Komisioni i Ristrukturimit që të sistemohet në të njëjtën pozitë sikurse në rastin paraprak, ndërsa sqarimi nga zyrtari i Këshillit ka qenë i tillë se Këshilli përmes Vendimit A.nr.928/2025 të datës 23.07.2025 ka anuluar Vendimin Ref.DBN-MM-5/441/2025 të datës 23.04.2025, U.D/ i Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe pjesën e Raportit të Komisionit të Ristrukturimit për Shërbimin Civil të Forcës së Sigurisë së Kosovës të datës 03.04.2025, ashtu që sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor, respektivisht nenit 14 paragrafi 1 Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, njësia përkatëse është e obliguar të nxjerr Vendim të ri për sistemin e nëpunësit civil, pa prejudikuar faktin e ligjshmërisë së propozimit të Komisionit të Ristrukturimit, apo në të kundërtën zyrtari përgjegjës duhet të deklarohet dhe të jap sqarime ligjore pse në rrethanat e rastit konkret nuk vepron sipas kuadrit ligjor në fuqi, çështje kjo e potencuar edhe në kërkesën sqaruese të datës 23.10.2025.*

Më pastaj, Këshilli me datë 11.11.2025 është njoftuar nga njësia përkatëse e Ministrisë së Mbrojtjes se U.D/ i Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore ka nxjerrë Vendimin me shifër Ref.DBN-MM-5/965/2025 të datës 11.11.2025, ashtu që ankuesi është sistemuara në pozitën “*Specialist i Administrimit të Rrjetave*”, sipas propozimit të Komisionit të Ristrukturimit përmes Raportit Plotësues të datës 13.08.2025, akt me të cilin është njoftuar edhe ankuesi, i cili më pastaj me datë 21.11.2025 përmes parashtrësës me numër protokoli:1748/2025 e plotëson ankesën e tij të datës 30.09.2025 ashtu që përveç raportit plotësues të datës 13.08.2025, tani e duke e kundërshton edhe Vendimin me shifër Ref.DBN-MM-5/965/2025 të datës 11.11.2025, duke qëndruar pranë Pretendimeve të ngritura si në ankesë, me theks të veçantë që organi i punësimit të marrë për bazë pikëpamjet e dhëna juridike si në Vendimin e Këshillit A.nr.928/2025 të datës 23.07.2025.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, dhe konstatimit të saktë të gjendjes faktike në rrethanat e rastit konkret, Këshilli sërish përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 24.11.2025 i drejtohet Drejtorit të Departamentit për Politika të Personelit dhe Rekrutim D-BNJ me kërkesën si në vijim: “*Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e treguar institucional, ju lutëm të na ofroni sqarimet e nevojshme si në vijim:*

A ka pozita të lira të Kategorisë Profesional 1, që janë ekuivalente me klasën sipas pozitës që ka mbajtur ankuesi, “Specialist i Mbështetjes Teknike për Rrejtja” A0, dhe A mund të na konfirmoni faktin nëse pozita “Specialist i Mbështetjes Teknike për Rrejtja” A0, është shuar/ndryshuar si pozitë në kuptim të nivelit të gradës, apo nëse pozita në fjalë sipas Gradës A0 është përcaktuar për stafin ushtarak”, ndërsa lidhur me kërkesën përkatëse me datë 24.11.2025 U.D/ i Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ka kthyer përgjigjen si në vijim: *“I nderuar, Duke ju referuar kërkesës tuaj për sqarim lidhur me koeficientin dhe ndryshimit të pozitës në procesin e ri sistemit, më lejoni t’ju ofrojë këtë përgjigje. Në pajtim me vendimin KPMSHCK i datës 23.07.2025 me nr. prot 5009/2025, Komisioni i ristrukturimit ka përgatitur raportin me datë 13.08.2025 me nr. prot. 1082, lidhur me zbatimin e këtij vendimi, dhe me të cilën komisioni ka përgatitur raportin me të dhënat e plota dhe sqaruese dhe propozimin në lidhje me rastin sistemit tuaj. Komisioni ristrukturimit për sistemin e nëpunësve civil të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ka bërë të ditur se procesi i riorganizimit të Tabelës Organizative të Forcës së Sigurisë së Kosovës, i miratuar me Urdhrin e KOMFSK-së, me nr.prot.4646 datë 20.12.2024, ka rezultuar me ndryshime në disa pozita civile ndër të cilat edhe pozita paraprake e juaj, cila ka pësuar ndryshime në titull, gradë dhe në numër të shërbimit. Komisioni i Ristrukturimit, pas rishqyrtimit të tërësishëm të rastit tuaj ka propozuar sistemin tuaj në pozitën siç është propozuar në raportin me numër protokolli 700, datë 03.04.2025, pasi që pozita paraprake në të cilën ju keni qene i emëruar cila ka pësuar ndryshime në titull, gradë dhe në numër të shërbimit, po ashtu pozita në të cilën ju jeni sistemuar është pjesë e pozitave të cilat MM/FSK vlerëson dhe ka kërkuar nga Komisioni për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike për t’i njohur si pozita të ekspertëve. Ministria e Mbrojtjes është në pritje të miratimit të kësaj liste nga ana e Komisionit për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike dhe në pajtim me vendimin që do të merr komisioni në fjalë, do të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për implementimin e saj në sistemin e pagesave. Ky raport i Komisionit të ristrukturimit i është dërguar edhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil si detyrim për njoftimin e tij nga ana e Komisionit të Ristrukturimit. Në pajtim me komunikimet e bëra me KPMSHCK-së, KPMSCHK ka kërkuar që edhe përkundër raportit që është dërguar nga Komisioni i Ristrukturimit, organi i punësimit, gjegjësisht burimet njerëzore janë të obliguar që të nxjerrin vendim për emërimin e nëpunësit ankues edhe nëse ky vendim nuk paraqet ndonjë ndryshim nga vendimet paraprake. Për rrjedhojë ne si burime njerëzore kemi nxjerrë vendimin nr pro. 5794 datë 11.11.2025. Si përfundim, ne ju njoftojmë se në këtë fazë, ne si Institucion nuk do të mund të marrim ndonjë vendim tjetër siç ju keni kërkuar, deri sa Komisionit për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike të merr vendim për njohjen e pozitave të eksperteve sipas kërkesës së Ministrisë së Mbrojtjes, dërguar me datë 05.05.2025 nr.prot.1082”,* dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit thekson faktin se U.D/ i Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“2. Institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, si dhe çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që ka kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo ka informacion në këtë fushë, janë të obliguar të bashkëpunojnë me Këshillin”,* ngase përmes shkresës në fjalë i është shmangur kërkesës për informata zyrtare nëse në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes ka pozita të lira të Kategorisë Profesional 1, që janë ekuivalente me klasën sipas pozitës që ka mbajtur ankuesi, “Specialist i Mbështetjes Teknike për Rrejtja” A0, apo sikurse nëse pozita “Specialist i Mbështetjes Teknike për Rrejtja” A0, është shuar/ndryshuar si pozitë në kuptim të nivelit të gradës, apo nëse pozita në fjalë sipas Gradës A0 është përcaktuar për stafin ushtarak.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas analizimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave të marrë bashkë si tersi, Kolegji i Këshillit konstatoi faktin se organi i punësimit, respektivisht Komisioni i Ristrukturimit për stafin civil në Ministrinë e Mbrojtjes me rastin e shqyrtimit apo rishqyrtimit të lëndës së ankuesit ka bwrw shkelje materialë të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe shkelje procedurale të përcaktuar në Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për arsyet e dhëna si në vijim:

Fillimisht, Kolegji i Këshillit thekson faktin se duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara nga nenin 66 paragrafi 1 i Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.”*, konstaton se në rrethanat e rastit konkret te rasti i ankuesit ky parakusht ligjor nuk është plotësuar, ngase i njëjti me rastin e parashtrimit të ankesës së datës 30.09.2025, ka paraqitur provë materiale, tabelën e organizmit të njësisë në kuadër të së cilës vepron se pozita në fjalë të cilën e ka mbajtur sipas Akt Emërimit AE.Nr.5/585/2022 të datës 24.10.2022, *“Specialist i Mbështetjes Teknike për Rrjeta”*, nuk është shuar, nuk i është ndryshuar titulli dhe as grada, por se në pozitën e njëjtë është sistemuar stafi ushtarak (Tetar, OR-4), ndërsa Komisioni i Ristrukturimit këtij fakti i ishte shmangur, madje kishte deklaruar se pozita në fjalë ka ndryshuar gradë dhe titull, kurse njësia përgjegjëse në kërkesën e Kolegjit të Këshillit të datës 24.11.2025 nëse pozita *“Specialist i Mbështetjes Teknike për Rrejtë”* A0, është shuar/ndryshuar si pozitë në kuptim të nivelit të gradës, apo nëse pozita në fjalë sipas Gradës A0 është përcaktuar për stafin ushtarak, nuk ka marrë përgjigje, për çka edhe u pasqyrua si më lartë edhe në arsyetimin e këtij vendimi, nga rrjedhë se pa arsyetim ligjor nga organi i punësimit për veprimet e këtij të fundit, nuk mundet të anashkalohet ky fakt dhe argument ligjor, ndërsa gjendja faktike përbën shkak të mjaftueshëm ligjor që ankesa e ankuesit të aprovohet, pasi që organi i punësimit nuk ka arritur ta dëshmojë me prova bindëse se pozita e ankuesit është shuar, ndryshuar apo ulur në gradë, ndërsa Kolegji i Këshillit thekson faktin se pozita në të cilën është propozuar të sistemohet ankuesi është pozitë e re e krijuar, ngase edhe vetë Komisioni i Ristrukturimit konstaton një fakt të tillë se pozita në fjalë nuk është pjesë e Katalogut të Vendeve të Punës.

Po ashtu, Kolegji i këshillit sjell në vëmendje se Kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit janë të përcaktuara me nenin 66 paragrafi 3 dhe 7 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 13 të Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, nga rrjedh se i njëjti Komision nuk ka mandat ta klasifikojë një pozitë në kuadër të shërbimit civil, pasi që sipas rregullores në fjalë për çështje përkatëse të klasifikimit, respektivisht sipas nenit 24 të Rregullore Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, kjo kompetencë i takon apo i njihet Grupit të Vlerësimit për Klasifikim, trup kjo e cila themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit sipas nenit 25 paragrafi 1 i së njëjtës rregullore, respektivisht në rrethanat e rastit konkret kjo trup duhet të themelohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, prandaj kur Komisioni i Ristrukturimit me rastin e propozimit për sistemimin e ankuesit sipas Raportit Plotësues të datës 13.08.2025 kur deklaroi dhe konstaton se pozita Specialist i Administrimit të Rrjetave në të cilën është propozuar të sistemohet ankuesi, nuk është pozitë në kuadër të Katalogut të Vendeve të Punës dhe kjo pozitë duhet të klasifikohet në Klasën Profesional 2, në këtë rast bie ndesh me ligjin material dhe kuadrin ligjor në fuqi që rregullon çështjet e klasifikimit të pozitave në shërbimin civil, respektivisht kanë shkelur normën e përcaktuar më lartë dhe

pasqyruar si në arsyetimin e këtij vendimi, ngase nuk kanë mandatin dhe as autorizimet ligjore për të klasifikuar një pozitë në Shërbimin Civil.

Sikurse, Kolegji i Këshillit po ashtu thekson faktin se edhe sikurse organi i punësimit të argumentonte me prova bindëse se pozita të cilën e ka mbajtur ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 24.10.2022 është shuar, nuk do të mundte qysh në fillim ta propozonte për sistemim ankuesin nga Klasa Profesional 1, në Klasën Profesional 2 duke e dëmtuar kështu në pagë, pasi që ligji material për fushën përkatëse, respektivisht neni 33 i Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ka përcaktuar se edhe në rastet kur një nëpunës civil i cili aktualisht është i vendosur në një klasë të kategorisë profesionale dhe nuk posedon nivelin dhe llojin e arsimit të përcaktuar për atë klasë, sipas kësaj Rregulloreje, vazhdon të mbaj pozitën nëse së paku tri vitet e fundit ka vlerësim pozitiv të rezultateve në punë, pra frymë e normës është e tillë, që fillimisht duhet bërë përpjeke që nëpunësi civil të sistemohet në klasën ekuivalente me klasën që ka mbajtur, dhe vetëm kur të shteren mundësit përkatëse ligjore, hapet rrugë që nëpunësi civil të transferohet në kudër të së njëjtës kategori, edhe nëse klasa dallon, kurse në rrethanat e rastit konkret tek ankuesi, Kolegji i Këshillit ia kishte tërhequr vëmendjen Komisionit të Ristrukturimit përmes Vendimit A.nr.928/2025 të datës 23.07.2025, se duhen të merren parasysh përcaktimet ligjore në fjalë, ndërsa të njëjtit me veprimet e tyre shihet qartë se kanë shpërfillur pikëpamjet e dhëna juridike, prandaj Kolegji i Këshillit përmes kërkesës sqaruese të datës 24.11.2025 kishte kërkuar informata shitesë nga njësia përgjegjëse nëse në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes ka pozitë të lirë e cila për nga klasa është ekuivalente me pozitën që ka mbajtur ankuesi, ngase sipas Akt Emërimit të datës 24.10.2022 pozita e ankuesit ishte ekuivalente me Kategorinë Profesional 1, kurse me rastin e transferimit është propozuar për transferim në Klasën Profesional 2.

Andaj nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit pas konstatimit të gjendjen faktike të pasqyruar si më lartë, dhe pasi mori përbazë dispozitat e aplikuara të ligjit material, erdhi në konstatimin se organi i punësimit me rastin e zhvillimit të procedurës së transferimit të ankuesit për shkak të ristrukturimit të institucionit, kanë vepruar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: *“1. Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunëses/it civil, nëpunëses/it të shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë partiake dhe mosdiskriminimit.”* dhe po ashtu është vepruar në kundërshtim edhe me nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.”* si dhe në kundërshtim nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme”,* dhe mbi këtë bazë si dhe në bazë të të gjeturave si më lartë, e me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, konstatoi se në mbështetje të nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 11.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i*

diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme”, Raporti Plotësues Nr.1082/2025 i datës 13.08.2025 i Komisionit të Ristrukturimit është i paligjshëm dhe për rrjedhojë edhe Vendimi me shifër Ref.DBN-MM-5/965/2025 i datës 11.11.2025, dhe u vendos sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ashtu që u aprovua ankesa e ankuesit e datës 30.09.2025, dhe u anuluan aktet e paligjshme të përcaktuara si në pikën II të dispozitivit, ndërsa lënda u kthye në rishqyrtim dhe rivendosje te Komisioni i Ristrukturimit për Shërbimin Civil të Forcës së Sigurisë së Kosovës i Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa komisioni në fjalë, është i obliguar që të zbatoj drejtë dispozitat e aplikuara të ligjit material që trajtojnë çështjet e transferimit të nëpunësve civil me rastin e ristrukturimit të institucionit si dhe të marrë përbazë pikëpamjet e dhëna juridike si në vendimin e Këshillit A.nr.928/2025 të datës 23.07.2025, sikurse duhet të marrë përbazë po ashtu edhe pikëpamjet e dhëna juridike si në këtë Vendim A.nr.1748/2025, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare që nëpunësit civil në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes të zbatojnë legjislacionin përkatës, pasi që moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga neni 21 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërlidhur me nenin 56 paragrafi 4, nën paragrafi 4.20 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat e Publik.

Ndërsa lidhur me deklarin e U.D/ i Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, të datës 24.11.2025 ku ndër tjera potencon se, **citoj:** *“Si përfundim, ne ju njoftojmë se në këtë fazë, ne si Institucion nuk do të mund të marrim ndonjë vendim tjetër siç ju keni kërkuar, deri sa Komisionit për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike të merr vendim për njohjen e pozitave të ekspertëve sipas kërkesës së Ministrisë së Mbrojtjes, dërguar me datë 05.05.2025 nr.prot.1082”*, Kolegji i Këshillit thekson faktin se ky qëndrim përbën interpretim të gabuar të ligjit material për shërbimin civil, respektivisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat e Publik, ligj me të cilin përcaktohet dhe rregullohet çështja e transferimit të nëpunësve civil me rastin e ristrukturimit të institucionit, kurse çështje e njohjes apo jo të pozitave në listën e ekspertëve është fushë e ndarë nga kjo çështje pasi që rruga ligjore që duhet ndjekur dhe hapat procedural për këtë fushë janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-196 Për Pagat Në Sektorin Publik dhe rregulloren përkatëse për ekspertët, nga rrjedh se çështjet në fjalë edhe mund të koincidojnë të kenë subjekt të përbashkët/nëpunës civil, por nuk janë përjashtuese ndaj njëra tjetrës, respektivisht kërkesa në vete që një pozitë përkatëse të vlerësohet ose jo si pozitë në kuadër të listës së Ekspertëve nga Komisioni përkatës shtetëror për Vlerësime Strategjike, nuk përbën shkak e as argument ligjor që procesi i ristrukturimit të pezullohet.

Në këtë rast Kolegji i Këshillit për shkak të këtyre rrethanave dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, nuk është lëshuar në pretendimet tjera ankimore si në ankesë, për shkak që varësisht nga procesi i rishqyrtimit, ankuesit nuk mund t'i mohohet e drejta për të filluar procesin e ankimit nëse pretendon se me veprimet e organit përkatës të punësimit i janë cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e punës.

Thënë si më lartë, duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2. dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1748/2025, datë 26/11/2025

Flakron Gashi

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit E.Sh;
- Ministrisë së Mbrojtjes: (Sekretarit të Përgjithshëm, Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore dhe Komisionit të Ristrukturimit), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.